



i Republikë e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit te Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 511/2024  
Nr./fa/Bi str./Nr.pg.  
Data/Datum/Date: 26/06/2024

PRIŠTINE, PRISTINA-PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT

### I

### AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 511/2022

në lidhje me zvarritjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë për  
lëndën C.nr.2272/17

Drejtuar: Znj. Albina Shabani Rama, kryetare  
Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, më 26 qershor 2024

## Qëllimi i raportit

1. Ky Raport ka për qëllim që t'ia tërheqë vëmendjen Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP) lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për shqyrtimin dhe vendosjen pa vonesa të mëtutjeshme në lëndën C.nr.2272/17.
2. Ky rapport është i bazuar në ankesën e znj. Radunka Topçiov (në tekstin e mëtejmë: ankuesja), dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankueses, si dhe në shkresat e lëndës, të cilat i posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në lëndën C.nr. 2272/17.

## Baza ligjore

3. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
4. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, nen 16, paragrafi 8, përcakton: “*Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme përfundimino e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përvèç rastit kur ka zvarritje të procedurave.*”

## Përbledhje e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat, të cilat i posedon IAP-ja, mund të përbledhen si në vijim:

5. Nga informacionet të cilat i ka në dispozicion Institucioni i Avokati të Popullit (IAP) dhe në bazë të pretendimeve të përfaqësuesit të ankueses, kuptohet se ankuesja është trashëgimtare ligjore e nënës, tashmë të ndjerë, znj. Kruna (Millan) Millosavljeviq (orig. Kruna (Milan) Milosavljević), e cila kishte ndërruar jetë më 12 dhjetor 1990 dhe e cila kishte lënë pas vetes palaujtshmëri në Komunën e Prishtinës, përkatësisht në Lagjen Veternik, të evidentuar në regjistrin kadastral me numrin P-71914059-01808-9, sipas certifikatës së Njësisë Kadastrore, me numër e lëndës: 11-942/03-0178003/21 me PL.nr.8744, në sipërfaqen prej 713m<sup>2</sup>.
6. Lidhur me këtë çështje, ankuesja ka theksuar se gjatë vitit 2000, palaujtshmëria në fjalë ishte uzurpuar në mënyrë të paligjshme nga palët e treta, të cilat e kishin rrënuar shtëpinë e familjes, kishin ndërtuar objekte të reja banimi dhe kishin uzurpuar tërë pronën e palaujtshme.
7. Në këtë drejtim, më 29 gusht 2017, në Gjykatën Themelore në Prishtinë ishte parashtruar padi nga ana e palës së tretë për vërtetimin e të drejtave të pronësisë mbi palaujtshmërinë e lartpërmendur, si dhe ishte kërkuar masa e përkohshme e sigurimit. Lënda në gjykatë ishte evidentuar me numrin C.nr.2272/17.
8. Më 31 gusht 2017 GjThP-ja kishte nxjerrë Aktvendimin C.nr.2272/17 dhe kishte vendosur masën e përkohshme të sigurimit, me të cilën kundërshtarit të sigurimit i ndalojë çdo procedurë ligjore e tjetërsimit, përdorimit, shërbimit apo ndërmarrjes së veprimtarive në ndryshimin e gjendjes faktike mbi palaujtshmërinë e kontestuar.
9. Përkitazi me këtë çështje, përfaqësuesi i ankueses ka njoftuar se në rastin në fjalë ishin ndërruar tre gjyqtarë. Po ashtu ai ka pohuar se periodikisht dërgojnë urgjenca në GjThP,

por deri në kohën e parashtrimit të ankesës tek Avokati i Popullit, ata nuk kanë informacione nga gjykata se kur do procedohet çështja në fjalë.

10. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 30 dhjetor 2021 kishte pranuar ankesë nga znj. Radunka Topçiov, e cila ankohej për zvarritjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, lidhur me lëndën C.nr 2272/17.
11. Më 17 tetor 2022, Avokati i kishte dërguar shkresë kryetarit të GjThP-së dhe i kishte kërkuar informata lidhur me rastin në fjalë. Më 28 tetor 2022, kryetari i GjThP-së kishte kthyer përgjigje dhe e kishte njoftuar Avokatin e Popullit se lidhur me rastin C.nr. 2272/17, më 31 gusht 2017 GjThP-ja kishte nxjerrë aktvendim me të cilin ishte vendosur masa e përkohshme e sigurimit, sipas së cilës, kundërshtarit të sigurimit i ndalohej çdo procedurë ligjore e tjetërsimit, përdorimit, shërbimit apo ndërmarrjes së veprimittarive në ndryshimin e gjendjes faktike mbi paluajtshmërinë e kontestuar, ndërsa për çështjen meritore, GjThP-ja kishte njoftuar se do të vendoste sipas radhës së lëndëve.
12. Më 2 mars 2023, Avokati i Popullit përsëri i kishte dërguar shkresë kryetarit të GjThP-së dhe i kishte kërkuar informata lidhur me rastin në fjalë. Më 15 mars 2023, kryetari i GjThP-së kishte kthyer përgjigje dhe e kishte njoftuar Avokatin e Popullit se lidhur me rastin në fjalë, gjyqtarja e rastit nuk kishte ndërmarrë veprime të tjera, sepse ishte në shqyrtim të lëndëve më të vjetra.
13. Më 12 shkurt 2024, Avokati i Popullit përsëri i ka dërguar shkresë kryetarit të GjThP-së dhe i ka kërkuar informata lidhur me rastin në fjalë. Më 4 mars 2024, kryetari i GjThP-së ka kthyer përgjigje dhe e ka njoftuar Avokatin e Popullit se lidhur me rastin në fjalë, gjyqtari i rastit nuk ka ndërmarrë veprime të tjera, sepse është në shqyrtim të lëndëve më të vjetra.
14. Më 16 maj 2024, përfaqësuesi i ankueses e ka njoftuar Avokatin e Popullit se ende nuk ka asnjë zhvillim të procedurës gjyqësore nga ana e gjykatës.

#### Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, përcakton: “*Republika e Kosovës mbrojnë drejtat e njërit të liritë themelore [...].*”
16. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përcaktohet me nenin 31.1 të Kushtetutës: “*Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*”
17. Po ashtu mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e përcaktuar me nenin 54 të Kushtetutës, parashevë: “*Çdo kush gjëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*”
18. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është dokument ligjor drejtëpërdrejt i zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.<sup>1</sup> Ndërsa paragrafi 1

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nen 22.

i nenit 6 të KEDNj-së garanton: “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor.*”

19. Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat, në nenin 7, paragrafi 2, përcakton: “*Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë, në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.*”
20. Ndërsa nenin 7, paragrafi 5, i Ligjit për Gjykatat përcakton: “*Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.*”

### **Analiza ligjore**

21. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).
22. GjEDNj-ja, në disa raste, ka theksuar se e drejta e palës që për çështjen e saj të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
23. Avokati i Popullit gjen se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih mes të tjerash Aktgjykin *Moldovan* dhe të tjerët kundër *Rumanisë*, më 12 korrik 2005, dhe aktgjykin *Sienkiewicz* kundër *Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykin *Poitier* kundër *Francës*, më 8 nëntor 2005).
24. Avokati i Popullit, lidhur me mosinformimin e palës për fazën në të cilën gjendet lënda e vet, gjen se sipas vendimeve të GjEDNj-së, një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoritetave kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykin *Zimmermann* dhe *Steiner* kundër *Zvicrës*, 13 korrik 1983).
25. Sipas praktikës së gjykatë (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet nga data 29 gusht 2017, kur ankuesja kishte parashtruar padi në GjThP, e deri në ditën e publikimit të këtij raporti.
26. Njëkohësisht, mungesa e mjeteve efektive për trajtimin e shkeljes të së drejtës për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, e drejtë kjo e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës [E drejta për zgjidhje efektive], i cili përcakton: “*Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.*”

27. Më tej, nenit 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht t'i mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për një individ, që bën të mundur që ai/ajo t'i gjëzojë të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase, nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrojë këtë ankesë te një autoritet vendor. Kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (shih Aktgjykimin *Kudla kundër Polonisë*). Kështu, nenit 13 garanton një mjet ankimi efektiv te një autoritet vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6, për ta shqyrtauar një rast gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Pasi rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, nenit 13 i Konventës është i zbatueshëm.
28. Për sa i përket zbatimit të nenit 13, Avokati i Popullit rikuhton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në procedurë nuk kanë mjete efektive për ankrim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).
29. Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikuhton se efekti i këtij nenit është ekzistencë e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankesë të kontestueshme” sipas Konventës dhe ta lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë, ashtu edhe në ligj (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).
30. Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikuhton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të kishin qenë në gjendje ta parandalonin shkeljen e pohuar apo mosvazhdimin e saj, ose të ofronin përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimin e lartpërmendor *Kudla*).
31. Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor, përmes të cilit ankuesja do të kishte mundur të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur. çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit.

### Konstatimet e Avokatit të Popullit

32. Avokati i Popullit rikuhton se sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, kohëzgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore, e që në rastin konkret është 29 gusht 2017, dhe konstaton se zvarritja e tillë, pa vendim përfundimtar, shkel:
- *të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuara dhe të mbrojtura me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së;*
  - *të drejtën për mjete efektive juridike, e mbrojtur me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të KEDNj-së;*
  - *të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*

33. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrethanat e theksuara më sipër, në bazë të nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 16, paragrafi 8, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, si dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës, i

## REKOMANDON

### Gjykatës Themelore në Prishtinë:

- Pa vonesa të mëtejme t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për ta shqyrtuar dhe për të vendosur për lëndën C.nr.2272/17.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkeseve të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkësë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit

